Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS**23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare

- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4.					
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficientë e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve: **SIPAS SPECIFIKIMEVE TEKNIKE BASHKELIDHUR NE SPE**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: SIPAS SPECIFIKEME TEKNIKE BASHKLEIDHUR NE SPE

Afatet e ekzekutimit:

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **BASHKIA POLIÇAN**

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

SIPAS FORMULARIT PERMBLEDHES TE DEKLARIMIT,SHTOJCA 10

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuara nga Operatori Ekonomik ofertues, dokumente këto të leshuara nga Administrata Tatimore, gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik, konkretisht të viteve financiare 2023,2024, 2025 ku vlera e xhiros së kerkuar, nuk duhet të jete me e

vogel se 40% e vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet, si dhe qe është realizuar gjate tre viteve te fundit financiare 2023,2024,2025.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri per kualifikim, Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese ne proceduren e prokurimit , nje vertetim të leshuar nga Administrata Tatimore,per xhiron vjetore te realizuar ne 3 vitet e fundit financiare, 2023,2024,2025 konform akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi, ku te jete pasqyruar vlera e xhiros per secalin vit te periudhes se kerkuar ne kerkesat per kualifikim.

Kërkesa për plotesimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e permbushur, nese Operatorët ekonomike pjesëmarrës arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, ne dokumentat e tenderit.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomikë ky kriter plotesohet nga secili anetar I bashkimit të operatoreve ekonomike, në raport me përqindjen dhe ose kushtet epjesemarrjes se tyre ne bashkim, konform dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi, perprokurimin Publik.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare konkretisht te viteve financiare (2023,2024,2025), të konfirmuara nga Administrata Tatimore, konform legjislacionit tatimor ne fuqi ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Operoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin ne proceduren e prokurimit pervec bilanceve tatimore dhe akt ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel i autorizuar, per tre vitet e kerkuara ne dokumentat e tenderit, konkretisht per tre vitet e fundit financiare 2023,2024,2025.

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne proceduren e prokurimit publik, per plotesimin e kerkesave per kapacitetin ekonomik dhe financiar.

Per plotesimin e ketij kriteri per kualifikim, duhet te paraqitet ne proceduren e prokurimit publik deklarate me shkrim nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues, sipas percaktimit te bere ne kete pike te kerkesave per kualifikim, pjese e dokumentave te tenderit

Ne rast deklarimi te pasakte apo te rreme, do te veprohet konform parashikimeve te Ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin Publik", si dhe VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit një vërtetim që ofertuesi ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2026, për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit, sipas parashikimeve të dhëna në Qendren Kombëtare të Biznesit.,

Në rastet e bashkimit të Operatoreve Ekonomike, çdo anëtar i grupit të Bashkimit të shoqërive duhet të paraqesë vërtetimin për pagesën për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2026 konform parashikimeve ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Lidhur me kapacitetet/aftësinë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) deshmi për realizimin me sukses të një apo disa kontratave, për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet si dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë **pesë** viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlerat, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, ku të jenë shënuar datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë të shënuara datat, shumat dhe sasitë dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve, shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i Bashkimit të Operatorëve, dhe prokurën .

2.3.1/b Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht

2.3.2 Operatori ekonomik për realizimin e këtij shërbimi duhet të disponoj **24 punonjes**, të cilët duhet të jenë në listat e shoqërisë të siguruar për 6-gjashtë muajt e fundit të specialitetëve si më poshtë:

- A. 11 (njembëdhjetë) punonjes për kryerjen e shërbimit të pastrimit, fshirjes së shesheve dhe trotuareve
- B. 2 (dy) punonjes për heqjen dhe transportimin e mbetjeve me mjet teknologjik
- C. 2 (dy) shofer, për heqjen e mbetjeve me mjet teknologjik dhe për drejtimin e mjeteve të tjera
- D. 2 (dy) punonjes për mirëmbajtjen e varrezave në Njësia Administrative Vertop dhe Polican
- E. 2 (dy) punonjes roje për kryerjen e shërbimit të ruajtjes së varrezave në Polican
- F. 5 (pese) punonjes për kryerjen e shërbimit të gjelberimit

Për plotësimin e këtij kriteri duhet të paraqesin vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore në të cilin të jete I përcaktuar numri i punonjesve të siguruar për çdo muaj konform legjislacionit në fuqi, si dhe listat e pagesave përkatëse sipas formularit E/Sig-25, për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore, të punonjesve, sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni Tatimor në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar

Për stafin e mësipërm, duhet të paraqiten ,

- **Kontrate pune, libere dhe leje drejtimi të pershtatshme për shoferet**
- **Kontrate pune dhe libere për punonjësit e tjerë**

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3.3 Operatorët ekonomikë ofertues, duhet të dorëzojnë në tender një deklaratë me shkrim nga ofertuesi që enti/ Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak, si dhe të bëjnë deklarin e adresës së saktë të vendodhjes së mjeteve teknologjike, me qëllim verifikimin e tyre.

Gjithashtu, Ofertuesi duhet të deklarojë me shkrim se është dakort që mjetet të paraqiten pranë komisionit të posaçëm për verifikimin e tyre, në vendin që do të përcaktojë Autoriteti Kontraktor, në rast se lindin dyshime për verifikimin e tyre nga shqyrtimi I dokumentacionit, si dhe transporti i tyre do të bëhet me shpenzimet e vete operatorit ekonomik ofertues.

Per plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, te paraqitet ne tender deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese, sipas te gjithë përcaktimit te bere ne kete kriter për kualifikim, pjese e dokumenteve te tenderit.

2.3.4 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin ne procedurën e prokurimit publik licensën profesionale te shoqërise, e cila duhet te jetë e vlefshme me kategorine per sherbime profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis,

- Kodit III.2.B, te leshuar nga organi Institucioni kompentent Shteteror **për veprimtaria e nënkategorisë specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme** Gjithashtu, kjo license duhet të jete e shoqëruar me akt miratimin e licenses e kategorise III.2.B, leshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, për grumbullim dhe transportim te mbetjeve urbane.
- Lishencë profesionale NP-12 A Punime në Inxhinieri Mjedis

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencën profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.3.5 Operatorët Ekonomike ofertues, te pakten **1 person te si drejtues teknik, te diplomuar ne Inxhinieri mjedisi, I përfshirë në lishencën e shoqërisë** per te cilen duhet te paraqitet ne tender kontrata e punes e vlefshme, diploma, libreza e punes, si dhe te figuroje ne listepagesa e shoqerise ofertuese, per te gjithë periudhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar

2.3.6 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin ne procedurën e prokurimit vertetim nga Drejtoria Rajonale e Transportit/Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ku te konfirmohet qe shoqeria ofertuese, nuk eshte debitore per taksat vjetore i mjeteve ne pronesi, gjoba te kontrollit teknik apo gjoba te tjera për te gjitha mjetet qe do te ofertojne në tender.

2.3.7 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te deklarojne se makinerite teknologjike te kerkuara ne kerkesat për kualifikim, nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera, apo ne asnjë punemarrje tjetër publike apo private.

Per plotesimin e ketij kriteri për kualifikim, pjese e dokumenteve te tenderit, Operatorët Ekonomike ofertues duhet te paraqesin ne tender deklarate me shkrim nga Administratori I shoqërise ofertuese. Mosparaqitja e kësaj deklarate ne formën dhe mënyrën e kerkuar, sipas percaktimit te bere ne kerkesat për kualifikim, perben kusht per skualifikim.

2.3.8 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te jenë te pajisur dhe te paraqesin ne procedurën e prokurimit publik çertifikatat perkatëse te vlefshme te ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalentet te tyre, dokumente te cilat duhet të jenë te lëshuara nga organizma nderkombetare ose shoqëri te akredituara në Republikën e Shqipërisë, si dhe të cilat duhet te jene te vlefshme ne datën e hapjes se procedures se prokurimit publik, si me poshte:

- Certifikatën ISO 9001:2015 (certifikatën e Menaxhimit te Cilësise se Punimeve, ose ekuivalenten e saj
- Certifikatën ISO 14001:2015, për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, ose ekuivalenten e saj.

2.3.9 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kete pjese te stafit te tij, i cili duhet te figuroje ne listpagesat e shoqërisë, per te gjithë periudhën e kerkuar ne dokumentet e tenderit,

- 1(nje) punonjes te kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun e menaxhimin e agjentëve kimike, sipas legjislacionit ne fuqi.
- 1 (nje) punonjes që permbush kriteret per te qene koordinator në fushen e sigurise dhe te shendetit ne pune sipas kerkesave te Ligjit nr. 10237, date 18.02.2010; "Për sigurine dhe shendetin ne pune" si dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 «Per miratimin e rregullores Për sigurine ne kantier»
- 1(nje) punonjes te kualifikuar sipas formimit profesional per veglat e dores manuale, sipas legjislacionit ne fuqi.

Per plotesimin e këtij kriteri për kualifikim, Kandidatet/Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin dokumenti i formimit profesional, i lëshuar nga institucione shteterore ose kompani te licensuara në fushën e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise për kurset e formimit profesional. kompani te licensuara ne fushen e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise për kurset e formimit profesional.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar

2.3.10 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë, sipas te gjitha mjeteve dhe paisjeve te nevojisme te percaktuara ne specifikimet teknike

2.3.11 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te paraqesin në procedurën e prokurimit publik nje deklarate me shkrim nga Administratori i shoqërise ofertuese që i gjithë informacioni dhe

dokumentacioni i paraqitur ne procedurën e prokurimit është i sakte dhe nuk permban te dhena të rreme për qellime kualifikim, si dhe AK rezervon te drejten e verifikimeve perkatese mbi te gjithë dokumentacionin e paraqitur ne procedurën e prokurimit, prane cdo organi apo institucioni ose autoriteti që i ka leshuar ato, ne rast se do te lindin dyshime mbi vertetësinë e tyre..

2.3.12 Operatoret Ekonomike ofertues, duhet te disponojne, ne pronesi ose me qira, sipas standatreve mjetet e mëposhtme, per kryerjen e sherbimit te pastrimit, me qëllim realizimin e objektit te prokurimit, si me poshte:

Makinat per kryerjen e sherbimit

- i. Automjet teknologjik 1 (nje) cope **Per heqje dhe transport mbeturinash nga kontenieret me kapacitet mbajtes 6-7 ton, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash, I cili duhet te jete I ri dhe sipas standarteve te BE,** per zerin e punimeve “Grumbullim dhe transport mbetjesh”,
- ii. Kamiocin 2-5 tone për larjen dhe dizifektimin e kontenierëve të mbetjeve urbane, e paisur me depoite uje jo me pak se 1000 lt, pompe larese sipas specifikimeve teknike per Zer in e punimeve “Larje konteineresh”,
- iii. Automjet 1-3 tone ,me spond anesor ose fundor te hpa ur per transportimin e punonjesve, veglave te punes .
- iv. Kontenier mbeturinash, 15 cope me kapacitet mbajtes ne volum 1.1 m3.

Sipas specifikimeve teknike shoqëruar me faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganimit dhe /ose kontrate furnizimi

- v. Per zerat e dekorit OE duhet të paraqesi një deklaratë që do të kontraktoj 1 mjetë makine ngjitje punime ne lartesi me qera per vendosjen e flaumjve banderolave ne lartesi parashikuar sipas kalendarit te festave zyrtare.

Te gjitha mjetet duhet te jene ne pronesi ose me qera si dhe te jene te shenuara ne regjistra publike.

Operatorti ekonomik për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur jane ne pronesi duhet të paraqitet:

- a) dokumenti që verteton regjistrimin/pronesin e mjetit(certifikaten e pronesise).
- b)leje qarkullimi;
- c)çertifikaten e kontrollit teknik;
- d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- e)çertifikatën për transport mallrash (leje transporti e vlefshme).

Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet.

- a) dokumenti që verteton regjistrimin/pronesin e mjetit(certifikaten e pronesise).
- b)leje qarkullimi;
- c)çertifikaten e kontrollit teknik;
- d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm);
- e)çertifikatën për transport mallrash (leje transporti e vlefshme sipas parasghikimeve te Kodit Rrugor per perdorim nga te trete dhe leja e transportit te jete e leshuar per kete qellim).
- g) kontraten perkatese noteriale te qerases/furnizimit . deri ne afatin e perfundimit te Kontrates se sherbimit te pastrimit.

- ❖ Në rastin e mjeteve te tjera qe nuk shenohen ne rregjistrat publik kur jane ne pronesi duhet te paraqitet kontrata e blerjes apo aktet e ç’doganimit faturat tatimore te blerjes dhe foto, ndersa per

mjete e marra me qera krahas ketij dokumentacioni (kontrata e blerjes apo aktet e ç'doganimit faturat tatimore te blerjes dhe foto) duhet dhe kontrata noteriale te qerese/furnizimit.

Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese foto per secilin mjet te deklaruar ne pronesi ose me qera ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit.

Do te njihen vetem mjetet e paraqitura ne pronesi ose me kontrate qeraje ose sipas LSH ne fuqi. Nuk do te pranohet blerja e mjeteve me kusht apo me kontrata paraprake blerje. Cdo makineri duhet te jete e shoqeruadetyrimisht me dokumentacioni e mesiperm te kerkuar ne kerkesat per kualifikim.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 10 të DST. Operatori ekonomike fitues duhet të paraqese përpara njoftimit te fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

2.3.13 Operatorët Ekonomike ofertues, duhet te kete ne pronësi ose me qira, nje ambjent me siperfaqe të mjaftueshme, jo më të vogël se 500 m², i cili do te sherbeje për parkimin e mjeteve jashte orareve te sherbimit, depozitimit dhe riparimin e kontenierëve te dëmtuar, si dhe për depozitimin e materialeve që i nevojiten shoqërise ofertuese, përrealizimin e plotë te sherbimit te pastrimit. Ambjenti duhet te kete servis për mirëmbajtjen emjeteve (ose kontrate shërbimi me një servis te autorizuar për riparim mjetesh, provuar me dokumentacion provues dhe vertetues mbi riparimin e mjeteve), si dhe uje te bollshëm

2.3.14. Operatori Ekonomik ofertues, duhet te paraqesi ne procedurën e prokurimit, së bashku me oferten e tij preventivin total, bashkelidhur me preventivat e detajuar per cdo ze i cili duhet te jete i shoqëruar me analizën e çmimeve. Mosparaqitja në formën dhe menyrën e duhur, perbën shkak per skualifikimin e ofertes ofertuese. Mosargumentimi i cmimit te ofertuar, sjell si pasoje skualifikimin e ofertës ofertuese.

Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i rregjistruar në një vend të huaj, atëhere mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjistrim të përkohshme cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës ose një deklaratë nga institucionet shtetërore, si dhe të jetë shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive. Dokumentacioni tjetër, sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesës për kualifikim.

Operatori ekonomik i kualifikuar i parë duhet të dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dhënia e informacionit te rreme, perbën kusht per penalizimin/perjashtimin e te githe të rreme, sipas parashikimeve te legjislacionit te prokurimit publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jene origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

